

LIGJ
Nr. 63/2024

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 65/2014, “PËR AGJENCINË E INTELIGJENCËS DHE SIGURISË SË MBROJTJES”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 65/2014 “Për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në pikën 2 të nenit 3 pas fjalëve “ose cenojnë” shtohen fjalët “ministrinë që mbulon fushën e mbrojtjes, strukturat në varësi të saj dhe”.

Neni 2

Kudo në tekstin e ligjit emërtimi “Ministri i Mbrojtjes” zëvendësohet me fjalët “ministri përgjegjës për mbrojtjen” dhe emërtimi “Ministria e Mbrojtjes” zëvendësohet me fjalët “ministra që mbulon fushën e mbrojtjes”.

Neni 3

Shkronja “a” e nenit 11 ndryshohet si më poshtë:

a) të ketë përvojë pune jo më pak se 5 vjet në pozicione drejtuese në struktura të inteligjencës ushtarake ose në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, në komandat e forcave, përfaqësitë apo në shtabet e NATO-s;”.

Neni 4

Neni 12 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 12

Zëvendës drejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes

1. Zëvendës drejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për marrëdhëniet e punës, nga ministri që mbulon fushën e mbrojtjes, me propozim të drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.”

2. Zëvendës drejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes është civil.

3. Zëvendës drejtori i përgjithshëm ka këto përgjegjësi:

- a) ndjek, zbaton dhe raporton detyrat e lëna nga drejtori i përgjithshëm;
- b) ndihmon drejtorin e përgjithshëm në kryerjen e funksioneve sipas fushës së veprimtarisë që mbulon;
- c) koordinon punën ndërmjet strukturave operacionale grumbulluese;
- ç) ndjek zbatimin e procedurave standarde të plotësimit të kushteve dhe të kriterëve të sigurisë së personelit;

- d) drejton dhe ushtron kontroll të drejtpërdrejtë mbi punonjësit, sipas fushës së përgjegjësisë;
- dh) kryen detyra administrative, përfshirë planifikimin, organizimin, mbikëqyrjen dhe menaxhimin e veprimtarisë së Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;
- e) kryen me delegim të drejtorit të përgjithshëm detyrat e drejtorit të përgjithshëm në mungesë të tij;
- ë) zëvendëson drejtorin e përgjithshëm në rast mungese në detyrë për një periudhë të pandërprerë, jo më shumë se gjashtë muaj;
- f) kryen çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga akte ligjore dhe nënligjore.”.

Neni 5

Pika 1 e nenit 17 ndryshohet si më poshtë:

“1. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, në përmbushje të misionit të saj, përdor dhe shfrytëzon për grumbullim informacioni disiplinat grumbulluese të inteligjencës, të cilat janë mënyra dhe sisteme të përdorura për të vëzhguar, kuptuar e regjistruar apo për të përçuar informacion mbi kushte, situata, kërcënime, mundësi dhe ngjarje”.

Neni 6

Në nenin 18 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, siguron informacionin e nevojshëm nëpërmjet metodave, mënyrave, sistemeve apo bazave të të dhënave në nivel kombëtar e ndërkombëtar.”.

2. Pika 2 shfuqizohet.

3. Pas pikës 4 shtohen pikat 5, 6 dhe 7 me këtë përmbajtje:

“5. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes përdor dhe shfrytëzon sistemin *edpshtrr* vetëm për leximin e të dhënave të nevojshme, si dhe vetëm për përmbushjen e nevojës për informacionin që kërkohet prej saj, kur ky informacion është i nevojshëm për të përmbushur funksionet e saj. Mënyra e përdorimit dhe procedurat specifike përcaktohen me udhëzim të përbashkët ndërmjet drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes dhe drejtorit të përgjithshëm të Transportit Rrugor, me propozim të drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, ku specifikohen masat organizative dhe teknike, në pajtueshmëri me rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas legjislacionit në fuqi.

6. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes përdor dhe shfrytëzon bazat e të dhënave të sistemit TIMS vetëm për leximin e të dhënave të nevojshme, si dhe vetëm për përmbushjen e nevojës për informacionin që kërkohet prej saj, kur ky informacion është i nevojshëm për të përmbushur funksionet e saj. Mënyrat e përdorimit dhe procedurat specifike përcaktohen me udhëzim të përbashkët ndërmjet drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes dhe drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, me propozim të drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, ku specifikohen masat organizative e teknike, në pajtueshmëri me rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas legjislacionit në fuqi.

7. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes përdor dhe shfrytëzon bazat e të dhënave të Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile vetëm për leximin e të dhënave të nevojshme, si dhe vetëm për përmbushjen e nevojës për informacionin që kërkohet prej saj, kur ky informacion është i nevojshëm për të përmbushur funksionet e saj. Mënyrat e përdorimit dhe procedurat specifike përcaktohen me udhëzim të përbashkët ndërmjet drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes dhe drejtorit të përgjithshëm të Gjendjes Civile, me propozim të drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, ku specifikohen masat organizative e teknike, në pajtueshmëri me rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas legjislacionit në fuqi.”.

Neni 7

Pas pikës 1 të nenit 20 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes pranon donacione nga vendet anëtare dhe agjencitë e NATO-s, persona fizikë e juridikë, vendas apo të huaj, me përjashtim të personave që janë në konflikt interesi me veprimtarinë e agjencisë. Donacionet në vlerë monetare bëhen pjesë e fondit për veprimtari specifike operative të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.”.

Neni 8

Pika 5 e nenit 28 ndryshohet si më poshtë:

“5. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, sipas përcaktimeve në rregulloren e brendshme të funksionimit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, i nënshtrohet procesit të arsimimit, trajnimit dhe kualifikimit pranë Shërbimit Informativ të Shtetit apo në institucionet arsimore ushtarake dhe civile, brenda dhe jashtë vendit.”.

Neni 9

Pikat 2 dhe 3 të nenit 29 ndryshohen si më poshtë:

“2. Funksione të nivelit të lartë drejtues janë:

- a) drejtor i përgjithshëm;
- b) zëvendësdrejtor i përgjithshëm.

3. Funksion i nivelit të mesëm drejtues është drejtor drejtorie.”.

Neni 10

Në pikën 3 të nenit 31 fjalët “në dy gazeta me qarkullim të madh kombëtar” zëvendësohen me fjalët “në faqen zyrtare të ministrisë që mbulon fushën e mbrojtjes”.

Neni 11

Në pikat 2 dhe 3 të nenit 32 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 2 të nenit 32 shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:

“c) çdo formë tjetër të përshtatshme të verifikimit të aftësive brenda fushës së përgjegjësisë dhe veprimit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.”.

2. Në fillim të paragrafit të dytë të pikës 3 shtohen fjalët “Format e tjera të përshtatshme të verifikimit,”

Neni 12

Në pikën 1 të nenit 33 bëhen këto ndryshime:

1. Në fjalinë e parë hiqen fjalët “ushtarak dhe”;

2. Fjala e dytë ndryshon si më poshtë:

“Gjatë kësaj periudhe punonjësi është nën kujdesin e eprorit, vlerësohet nga ky i fundit, si dhe duhet të kryejë trajnime familjarizuese dhe profesionale pranë strukturës përgjegjëse për trajnimet në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, me objekt njohjen me procedurat e punës në këtë agjenci.”.

Neni 13

Në nenin 34 bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

1. Në fund të pikës 2 hiqen fjalët “me propozim të komisionit të testimit”.

2. Pas pikës 2 të nenit 34 shtohen pikat 3, 4, 5 dhe 6 me këtë përmbajtje:

“3. Marrëdhënia e punës së punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes përfundon për shkak të lirimit në rastet kur:

- a) jep dorëheqjen nga detyra;
- b) përfundon kontratën e punës;

- c) vdes apo kur merr formë të prerë vendimi për deklarimin e vdekjes së tij;
 - ç) humbet shtetësinë shqiptare apo merr formë të prerë vendimi i gjykatës për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar;
 - d) deklarohet i paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor, sipas ligjit;
 - dh) plotësohet mosha për pensionin e plotë të pleqërisë;
 - e) nuk pajiset ose i hiqet certifikata e sigurisë;
 - ë) nuk ekziston më pozicioni i punës për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit;
 - f) konstatohet pavlefshmëria e aktit të emërimit;
 - g) nuk pranon të emërohet në një detyrë tjetër;
 - gj) përfundon kontratën e punës;
 - h) ka konflikt interesi me detyrën që kryen;
4. Marrëdhënia e punës së punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes përfundon për shkak të shkarkimit nga detyra në këto raste:
- a) pas dy vlerësimeve “jokënaqshëm” të rezultateve në punë;
 - b) kur mungon në detyrë pa arsye për më shumë se 30 ditë rresht;
 - c) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - ç) kryen shkelje të rënda disiplinore;
 - d) kryen akte dhe sjellje, që diskreditojnë rëndë pozitën e figurën e tij dhe të institucionit.
5. Punonjësi ushtarak i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes nxirret në rezervë apo në lirim nga shërbimi ushtarak, sipas legjislacionit në fuqi për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.
6. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, në momentin që lirohet ose shkarkohet nga detyra, dorëzon menjëherë detyrën.”.

Neni 14

Në pikën 3 të nenit 37 shkronjat “b” dhe “c” ndryshojnë si më poshtë:

- “b) jo më pak se 3 vjet, kur është drejtues i nivelit të ulët;
- c) jo më pak se 4 vjet, kur është drejtues i nivelit të mesëm.”.

Neni 15

Neni 40 shfuqizohet.

Neni 16

Pas nenit 48 shtohet neni 48/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 48/1

Ndalimi i ushtrimit të veprimtarive të dyta

Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes nuk mund të punësohet ose të kryejë veprimtari tjetër publike ose private, me përjashtim të mësimdhënies. Përpara se punonjësi të kryejë veprimtari mësimdhënieje, duhet të marrë më parë miratimin me shkrim të drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë.”.

Neni 17

Pika 2 e nenit 49 ndryshohet si më poshtë:

“2. Elementet përbërëse të pagës bruto mujore të punonjësve civilë të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes janë të njëjta me elementet përbërëse të pagës bruto mujore të të punësuarve në institucionet në varësi të ministrive. Vlerat për secilin element përcaktohen me vendim të Këshillit të

Ministrave, sipas legjislacionit në fuqi për kompetencat për caktimin e pagave të të punësuarve në institucionet e administratës publike.”.

Neni 18

Në pikën 2 të nenit 54 fjalët “në masën e gjysmës së pagës mujore” zëvendësohen me fjalët “në masën e një page mujore”.

Neni 19

Në nenin 61 bëhen këto shtesa:

1. Në fund të pikës 2 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Rregullat për mënyrën e raportimit të shkeljes disiplinore dhe ngritja e komisionit disiplinor përcaktohen në rregulloren e disiplinës së Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes miratuar nga ministri që mbulon fushën e Mbrojtjes.”.

2. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3/1. Masat disiplinore jepen si më poshtë:

a) për shkronjat “a” dhe “b” të nenit 60 nga drejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;

b) për shkronjat “c” dhe “ç” të nenit 60 nga autoriteti, i cili ka emëruar punonjësën në detyrë.”.

Neni 20

Në nenin 65 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 1 fjalët “10 ditëve” zëvendësohen me fjalët “30 ditëve kalendarike”;

2. Në pikën 2 fjalët “30 ditëve” zëvendësohen me fjalët “45 ditëve kalendarike”.

Neni 21

Nxjerrja dhe miratimi i akteve nënligjore

1. Ngarkohet ministri përgjegjës për mbrojtjen që brenda 6 muajve të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 19 të këtij ligji.

2. Ngarkohen drejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes dhe drejtori i përgjithshëm i Transportit Rrugor që brenda 6 muajve të nxjerrin udhëzimin e përbashkët në zbatim të pikës 5 të nenit 6 të këtij ligji.

3. Ngarkohen drejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes dhe drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit që brenda 6 muajve të nxjerrin udhëzimin e përbashkët në zbatim të pikës 6 të nenit 6 të këtij ligji.

4. Ngarkohen drejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes dhe drejtori i përgjithshëm i gjendjes Civile që brenda 6 muajve të nxjerrin udhëzimin e përbashkët në zbatim të pikës 7 të nenit 6 të këtij ligji.

Neni 22

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 27.6.2024.